



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Nr 2310/1 Prot

Tiranë, më 22/09 /2020

Lënda: Njoftim për shpallje të lëvizjes paralele

SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE _____

DREJTORISË RAJONALE TË FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK _____

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshilli të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”, Urdhërit nr. 107, datë 13.08.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive” dhe shkresës nr.412 prot, datë 15.09.2020 “Njoftim për shpalljen e lëvizjes paralele” të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër, protokolluar në AKPA me nr.2310 prot, datë 18.09.2020,

-Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ju njofton shpalljen e procedurave të **lëvizjes paralele** për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik, në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër, për pozicionet:

- 1 mësimdhënës i formimit teorik-praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Sekretari”

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër

Aplikanti për mësimdhënës të formimit teorik-praktik, në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;

- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojnë kriteret e posaçme për personelin mësimdhënës të formimit teorik-praktik në ofruesit e formimit profesional si vijon:

- a) të ketë minimalisht diplomë nga një shkollë e mesme profesionale/ pas të mesëm, kualifikim profesional mbi një vit në fushën/profesionin që lidhet me zhvillimin e kurrikulës së kulturës profesionale të ofruesit të formimit profesional;
- b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë pune në fushën, në të cilën është arsimuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Vendi dhe afati i dorëzimit të dokumentave

Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesën për lëvizje paralele dhe dokumentacionin përkatës pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër, brenda 5 ditëve nga njoftimi. Afati i njoftimit fillon më datë 24.09.2020.

Nëse nuk paraqiten kërkesa për lëvizje paralele brenda afatit të mësipërm, Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Shkodër të fillojë procedurën për shpalljen e vendit të lirë, për pozicionin:

- 1 mësimdhënës i formimit teorik-praktik, me kohë të pjesshme, për kursin “Sekretari”

në zbatim të Udhëzimit nr. 11, datë 3.3.2020 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional”.

Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Shkodër brenda 5 ditëve pune pasi është mbyllur procedura e lëvizjes paralele dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë për lëvizje paralele, shpall njoftimin për vendin e lirë në faqen zyrtare të AKPA-s, në faqen elektronike zyrtare të Drejtorisë Rajonale e Formimit Profesional Publik Shkodër, si dhe në një vend të dukshëm në hyrje të Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik Shkodër.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

